



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 7607
U. 02 Br. 7607
Nr. i faq. 1 Data: 02/04
Pr. Sh. Datum: 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.130, datë:01.04.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Hajdin Krivaqa** (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"Furnizim me Pemë dhe perime"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Hajdin Krivaqa**, për Projektin: **"Furnizim me Pemë dhe perime"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Hajdin Krivaqa (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit); dhe
- QSHQ - Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.131, datë: 01.04.2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016", Dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-115, si dhe Ligjin Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, dhe aktet tjera nënligjore, neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

1. Me këtë vendim themelohet Grupi Punues për Hartimin e Planit për Qëndrimin Gjithëditor në shkolla të Komunës së Kamenicës, Përbërja e grupit punues do të jetë si në vijim:

- 1.1. Afrim Dërvishi (Drejtor Komunal e Arsimit), Kryesues;
- 1.2. Selami Klaiqi (Drejtor Gjinnazi "Ismail Qemali"), Koordinator;
- 1.3. Visar Dërmaku (Drejtor Komunal e Arsimit), anëtar;
- 1.4. Ramadan Guda (Drejtor Komunal e Arsimit), anëtar;
- 1.5. Merita Keqmezi (Drejtor Shkolla Fillore "Abdullah Krashnica", Koretin), anëtare;
- 1.6. Belgizare Kryeziu (Drejtor Shkolla Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtare;
- 1.7. Besim Kryeziu (Mësimdhënës Shkolla Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtar;
- 1.8. Xhevrije Sabedinaj (Psikologe Gjinnazi "Ismail Qemali", Kamenicë), anëtare;
- 1.9. Sabit Zylfijaj (Mësimdhënës Gjinnazi "Ismail Qemali", Kamenicë), anëtar;
- 1.10. Agon Mahmuti (Mësimdhënës IAAP "Andrea Durrsaku", Kamenicë), anëtar;
- 1.11. Hanife Ferizaj (Pedagoge Shkolla Fillore "Skenderbeu", Hogosht), anëtare;
- 1.12. Arsim Guda (Drejtor Shkolla Fillore "Skenderbeu", Hogosht), anëtar;
- 1.13. Avni Maliqi (Mësimdhënës Shkolla Fillore "Abdullah Krashnica", Koretin), anëtar;
- 1.14. Hazbije Haxhiu (Mësimdhënëse Shkolla Fillore "Rexhep Mala", Topanicë), anëtare;
- 1.15. Aferdita Kallaba (Mësimdhënëse Shkolla Fillore "Metush Krasniqi", Rogaçicë), anëtare;
- 1.16. Adem Hashani (Mësimdhënës Shkolla Fillore "17 Shkurti", Muçivërcë), anëtar;
- 1.17. Bejaze Morina (Drejtor Komunal e Arsimit), anëtare; dhe
- 1.18. Florije Hoda (Mësimdhënëse Shkolla Fillore "Fan S. Noli", Kamenicë), anëtare.

2. Detyrat e grupit punues:

- 2.1. Hartimi i planit të detajuar profesional për qëndrimin gjithëditor në shkolla.
 - 2.2. Përgatitja e planit financiar për zbatimin e programit.
 - 2.3. Përzgjedhja e shkollave pilot.
 - 2.4. Krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe organizatat relevante.
 - 2.5. Dorëzimi i planit final pranë Kryetarit të Komunës.
3. Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) merr përsipër mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga puna dhe organizimet e grupit punues.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa mbikëqyrjen për zbatimin e tij e bën Kryetari i Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dorëzohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Drejtorisë Komunale të Arsimit, Anëtarëve të Grupit Punues dhe arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova U.
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.129, datë:01.04.2025

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 shkronja e) dhe shkronja f) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 24 paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga qeveria dhe ministrat, neneve 5 paragrafi 5.1 shkronja d), dhe 70 paragrafi 70.1 shkronja b), g) dhe i) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës me datë 01.04.2025 merr këtë:

VENDIM

1. Me këtë vendim themelohet Trupi Koordinues për hartimin e Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Kamenicës, Trupi Koordinues emërohet në këtë përbërje:
 - 1.1. Kadri Rahimaj (Kryetar i Komunës);
 - 1.2. Zotrim Kastrati (DSHPAIE);
 - 1.3. Uran Berisha (DUPH);
 - 1.4. Afrim Dërvishi (DKA);
 - 1.5. Greta Kryeziu (DSHMS);
 - 1.6. Shpend Morina (DBPZHR); dhe
 - 1.7. Faton Jakupi (Nënkryetar i Komunës).
2. Trupi Koordinues ka për detyrë:
 - 2.1. Të mbikëqyrë dhe të koordinojë procesin e hartimit të Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, duke siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe bashkëpunimin me Grupin Punues;
 - 2.2. Të organizojë takime dhe konsultime me palët e interesit për të siguruar përfshirjen dhe transparencën e procesit;
 - 2.3. Të ofrojë rekomandime dhe sugjerime për përmirësimin e Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis;
 - 2.4. Të bashkëpunojë me institucionet qendrore dhe donatorët për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare për hartimin e planit;

- 2.5. Të monitorojë dhe raportojë për ecurinë e hartimit të Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis;
- 2.6. Të mbështesë procesin e miratimit të Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis nga organet përkatëse.
3. Trupi Koordinues bashkëpunon me Grupin Punues për hartimin e Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis dhe mbështet procesin e miratimit të tij nga organet përkatëse.
4. Trupi Koordinues lirohet nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij me përfundimin e hartimit dhe dorëzimit të Draft Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për miratim dhe kthimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Trupit Koordinues;
- Drejtorive Komunale; dhe
- QSHQ – arkivit.




Kryetar i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova U.
Republic of Kosovo




REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Nr. 02
Br. 7967

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Br. str. 01

Data: 08/04/2025
Datum: 2025
KAMENICE/A



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.134, datë 07.04.2025

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 70 shkronja g) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, neni 15 i Rregullores Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

Për Caktimin e Personit Kontaktues për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Kamenicës

1. Me këtë Vendim, znj. Vesna Kenic (Zyra e Informimit), Caktohet Person Kontaktues që do të jetë përgjegjëse për përdorimin e gjuhëve.
2. Personi kontaktues do të kryej detyrat dhe përgjegjësit në përputhje me Rregulloren Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
4. Vendimit i bashkangjitet: Email-i zyrtar nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët dërguar më datë 07.04.2025 dhe Email-i zyrtar nga Zyrtarja për Mardhënie me Publikun në Zyrën e Kryetarit të Komunës dërguar më datë 07.04.2025.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit; Zyrës për Informim, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët, znj. Vesna Kenic (Zyra e Informimit), dhe QSHQ-arkivit.




Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.135, datë: 07.04.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016"), Vendimi Sh.02.Nr.12724 i datës 22.04.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim" me numër të kontratës KM653-24-2848-5-2-1, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Sh.02.Nr.12724 i datës 22.04.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim" me numër të kontratës KM653-24-2848-5-2-1

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.12724 i datës 22.04.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull **"LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim"** me numër të kontratës **KM653-24-2848-5-2-1**.
 - 1.1. Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.12724 i datës 22.04.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull **"LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim"** me numër të kontratës **KM653-24-2848-5-2-1**, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Menaxherit të Kontratës **z. Mexhid Zylfiu (DUPH)**, caktohet Menaxher i Kontratës **z. Leotrim Spahiu** (Konsulent, Drejtoria për Investime Kapitale).
2. Obligohet **z. Mexhid Zylfiu** që, në cilësinë e Menaxherit të Kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.12724 të datës 22.04.2024, të dorëzojë një raport të detajuar me shkrim lidhur me punët e kryera deri në periudhën e ndryshimit të vendimit në kontratën **"LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim"**, me numër të kontratës **KM653-24-2848-5-2-1**, dhe raportin t'ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, **z. Leotrim Spahiu** (Konsulent, Drejtoria për Investime Kapitale).

3. Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.12724 i datës 22.04.2024.
4. Këtij vendimi i bashkëlidhet kopja e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.12724, i datës 22.04.2024, për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, me titull “LOT 1 – Ndërtimi i parqeve në Kamenicë – Parku te qendra e vjetër - Ritenderim”, me numër të kontratës KM653-24-2848-5-2-1.
5. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, z. Mexhid Zylfiu (DUPH), z. Leotrim Spahiu (Konsulent, Drejtoria për Investime Kapitale), z. Besart Fejzullahu (DUPH) dhe Q.SH.Q - arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.133, datë: 07.04.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016"), Vendimi Sh.02.Nr.4606 i datës 26.02.2025 për lejin e pagesës në vlerë prej 1,200.00 €, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për korigjimin e pasaktësisë së Vendimit Sh.02.Nr.4606 të datës 26.02.2025

1. Me këtë vendim korigjohet pasaktësia e tekstit të paragrafit (3) tre të Vendimit Sh.02.Nr.4606 të datës 26.02.2025 për lejin e pagesës në vlerë prej 1,200.00 €, ashtu që **korigjohet: nga Kodi Buxhetor 85029 i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Kodi Buxhetor 16029 i Zyrës së Kryetarit.**
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit bazë Sh.02.Nr.4606 të datës 26.02.2025.
3. Vendimit i bashkangjitet: kopja e vendimit bazë Sh.02.Nr.4606 të datës 26.02.2025.
4. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa; dhe
- QSHQ-arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Nr. 02 Br. 8055
Nr. i faq. 1 Data: 08/04
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.135, datë:08.04.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Blerim Murina** (Drejtorja për Investime Kapitale), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"LOT 1 Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Kolloleq–Dajkoc–Muçivërc, LOT 2 Ndërtimi i rrugës qarkore në Kamenicë – Krah 2, LOT 3 Asfaltimi i rrugëve Livaxhe, Zajqeci, Mahmuti dhe Ahmeti"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Blerim Murina**, për Projektin: **"LOT 1 Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrugës Kolloleq–Dajkoc–Muçivërc, LOT 2 Ndërtimi i rrugës qarkore në Kamenicë – Krah 2, LOT 3 Asfaltimi i rrugëve Livaxhe, Zajqeci, Mahmuti dhe Ahmeti"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Blerim Murina (Drejtorja për Investime Kapitale); dhe
- QSHQ - Arkivit.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.139, datë: 08.04.2025

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.02.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, neneve 5, 7, 8 dhe 15, paragrafi 1 të Rregullores Sh.01.Nr.31251, të datës 29.09.2022, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurën e Ndarjes së Subvencioneve, si dhe duke u bazuar në përkrahje të të rinjve dhe promovim të vlerave arsimore, Kryetari i Komunës së Kamenicës vendos që të formojë Komisionin për vlerësimin e propozimeve nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe drejtorët e shkollave të mesme të Komunës së Kamenicës për nxënësit e shkëlqyer për qëllime subvencionimi të një udhëtimi edukativo-kulturor në Evropë, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit vlerësues për përzgjedhjen e nxënësve të shkëlqyer për subvencionimin e një udhëtimi në Evropë

1. Formohet Komisioni për vlerësimin e nxënësve të propozuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe drejtorët e shkollave të mesme të Komunës së Kamenicës, me qëllim të përzgjedhjes së përfituesve për subvencionimin e një udhëtimi edukativo-kulturor në Evropë, Komisioni do të përbëhet nga këta anëtarë:
 - 1.1. Edmond Kastrati (DKA), Kryesues;
 - 1.2. Bejaze Morina (DKA), anëtare;
 - 1.3. Edon Dërmaku (DZHED), anëtar;
 - 1.4. Besarta Ahmeti (DKA), anëtare;
 - 1.5. Valdete Morina (ZK), anëtare; dhe
 - 1.6. Nevzadije Shala (DBPZHR), anëtare rezervë në komision në rast konflikti të interesit nga anëtarët e tjerë.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e nxënësve të propozuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe drejtorët e shkollave të mesme të Komunës së Kamenicës. Vlerësimi do të bazohet në suksesin arsimor të nxënësve, sjelljen shembullore, përfshirjen në aktivitete jashtëshkollore, si dhe kriteret e tjera që përcaktohen nga vetë Komisioni në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit. Pas shqyrtimit të propozimeve, Komisioni do të përpilojë listën përfundimtare të përfituesve dhe do ta dorëzojë atë për miratim te Kryetari i Komunës.

3. Komisioni obligohet që brenda një afati të arsyeshëm nga dita e formimit, të përfundojë procesin e vlerësimit dhe t'ia dorëzojë raportin përfundimtar Kryetarit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendim t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Drejtorisë Komunale për Arsim;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ – Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.140, datë:08.04.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (nr.03/L-040), nenit 81 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik, nenit 70, paragrafi 70.18 i Rregullorës Nr.001/2022 për Prokurim Publik i nxjerr nga KRPP-ja, Kontrata Sh.02.Nr.8021 e datës 08.04.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Menaxherit të Kontratës “Furnizim me boca të Oksigjenit për QKMF-në”

1. CAKTOHET Menaxheri i kontratës me titull: **“Furnizim me boca të Oksigjenit për QKMF-në”**, me numër të kontratës **KM653-25-1634-1-3-6**, si në vijim:
2. **z. Ferid Beqiraj (QKMF)**, CAKTOHET Menaxher i kontratës sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
3. Obligohet menaxheri i kontratës që të hartoj planin e menaxhimit të kontratës, bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualet për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

T’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Ferid Beqiraj (QKMF); dhe
- QSHQ-arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS.
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRA
Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Sh. 02 Nr. 8191
U. Br. 10/04
Nr. i faq. 2 Data: 10/04
Br. str. Datum: 2025
KAMENICE



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.136, datë: 07.04.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016"), Vendimi Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve" me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimi Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve" me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1

- Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull **"Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve"** me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**.
 - Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull **"Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve"** me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Menaxherit të Kontratës **z. Mexhid Zylfiu (DUPH)**, caktohet Menaxher i Kontratës **z. Sylejman Kallaba (DUPH)**.
- Obligohet **z. Mexhid Zylfiu** që, në cilësinë e Menaxherit të Kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull **"Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve"** me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**, dhe raportin t'ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, **z. Sylejman Kallaba (DUPH)**.
- Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024.

4. Këtij vendimi i bashkëlidhet kopja e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.26179 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull “Konsulent për Planifikim, menaxhim dhe zbatim të projekteve” me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1.
5. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, z. Mexhid Zylfiu (DUPH), z. Sylejman Kallaba (DUPH), z. Mehmet Thaçi (DUPH) dhe Q.SH.Q - arkivi.


Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02 Nr.138, datë: 08.04.2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13, nenit 58, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), si dhe nenit 53, paragrafi 3, të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016"), Vendimi Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve" me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1, si dhe neni 70 paragrafi 70.1 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimi Sh.02.Nr.26181 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve" me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1

- Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet **paragrafi 1** (një), **nënparagrafi 1.1** (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "**Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve**" me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**.
 - Paragrafi 1 (një), nënparagrafi 1.1 (një pikë një) i Vendimit Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "**Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve**" me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim: Në vend të Menaxherit të Kontratës **z. Mexhid Zylfiu** (DUPH), caktohet Menaxher i Kontratës **z. Sylejman Kallaba** (DUPH).
- Obligohet **z. Mexhid Zylfiu** që, në cilësinë e Menaxherit të Kontratës sipas Vendimit Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull "**Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve**" me numër të kontratës **KM653-24-7001-2-2-1**, dhe raportin t'ia dorëzojë Menaxherit të ri të kontratës, **z. Sylejman Kallaba** (DUPH).
- Ky vendim është pjesë përbërse e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024.

4. Këtij vendimi i bashkëlidhet kopja e Vendimit Bazë Sh.02.Nr.21681 i datës 16.08.2024 për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull “Konsulent për Hartimin dhe Zbatimin e projekteve” me numër të kontratës KM653-24-7001-2-2-1.
5. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me vendim të njoftohet: Zyra e Kryetarit, Zyra e Informimit, Zyra e Prokurimit, z. Mexhid Zylfiu (DUPH), z. Sylejman Kallaba (DUPH), z. Mehmet Thaçi (DUPH) dhe Q.SH.Q - arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Sh. 02 Nr. 8208
U. Br.

Nr. i ser.
Br. str. 1

REPUBLIKA KOSOVË
QENDRA PËR SHËRBIM TË QY
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Data: 10/04
Datum: 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.141, datë:10.04.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Hajdin Krivaqa** (DSHMS, Shtëpia e Komunitetit), Zyrtar Autorizues për Projektin: **"Shërbimet e transportit dhe akomodimit – Shtëpia e Komunitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara Mendore – sipas përkrahimit teknik"**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
